



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I TRASHËGIMISË KULTURORE TURIZMIT ARTE

Nr. 20 prot

Maliq, më 20 . 05 .2024

PROJEKT VENDIM - 1 x R. 8

PËR AKTIVITETIN KULTUROR 3 DITOR "SINEMANIA"

Në mbështetje të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 54 "detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak, germa dh, neni 25 " Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese" , ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 " përgatitja dhe miratimi i Buxheteve vendore " ,të ligjit Nr 68/2018 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" neni 45 "Rishpërndarjen e fondeve buxhetore", të ligjit Nr 97/2023 "Per buxhetin e vitit 2024", mbështetur në vendimin nr 138 dt 26.12.2023 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit për vitin 2024 " Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr 1 Datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024 ", kërkojmë nga ana juaj :

- 1- Miratimin për mbështetje financiare prej 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lek, aktivitetit artistik dhe kulturor « SINEMANIA », shfaqje filmash dhe koncerte artistik me këngëtarë të njohur.
- 2- Preventivi i aktivitetit Kombëtar "Open Cinema" 2024 tre netë
 - 1- Teknika e projeksionit150.000 lek
 - 2- Paneli i Ekranit të filmit150.000 lek
 - 3- Fonia.....30.000 lek
 - 4- Ndriçimi skenik.....20.000 lek
- 3- Miratimin e datave të aktivitetit 29,30dhe 31 Korrik 2024.

Financimi i Projektit do të përballohet nga buxheti I Sektorit të Trashëgimisë Kulturore Turizmit dhe Arte.

PËRGJEGJËSI

Festim Tomorri

KRYETARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I TRASHËGIMISË KULTURORE TURIZMIT ARTE

Nr. 21 prot

Maliq, më 20.05.2024

Relacion shjegues për aktivitetin Kulturor dhe Artistik "OPEN CINEMA "

Për të pasur një larmi aktivitete dhe për të sjellë një risi në aktivitetet verore që organizon Bashkia si dhe për t'i shtuar kënaqësitë artistike në shërbim të komunitetit, në qytetin e Maliqit, nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Bashkisë z. Gëzim Topçiu, do të organizohet në data 29,30 dhe 31 Korrik 2024, aktiviteti Kombëtar: "OPEN CINEMA".

Një ekran i madh 40m2 i cili vendoset në Shëtitoren e Bulevardit "RINIA" të qytetit, ku do të projektohen Premierat e fundit të kinemasë shqiptare si dhe asaj botërore. Këngëtar të njohur, Artistë, Kineastë, të ftuar do të jenë pjesë e këtij shoë artistik – kinematografik.

Aktiviteti do të filloj çdo mbrëmje në orën 8:30 dhe do të mbaroj në orën 12:00.

Në 3 netë rresht, një shoë plot atmosferë do të sjelli kënaqësi të veçantë për publikun jo vetëm të Maliqit por edhe të zonës për rreth dhe më gjerë.

Është përzgjedhur ky projekt nga ana jonë me të vetmen arsye, se kemi menduar që ekрани i madh i kinemasë aq i munguar në vite, të jetë prezentë edhe në qytetin e Maliqit, me prodhimet e fundit të kinemasë shqiptare dhe asaj botërore, si dhe muzikalitetin e bukur të këngës shqiptare e cila do të performohet nga këngëtarët të njohur kombëtarë. Në thelb të këtij do të jene Prodhimet e fundit të kinemasë shqiptare si dhe filmi të huaj të ri dhe nostalgjik. Gjithashtu dhe këngëtarë të njohur të cilët do të performojnë para ekranit. Ky aktivitet përcjell nga njeri brez tek tjetri, këtë gjini të bukur të artit të 7-të si dhe këngës të bukur shqiptare

Qëllimi i është për të shtuar një aktivitet të ri jetën kulturore të Bashkisë dhe më gjerë netët e nxehta të verës, në këtë zhaner të bukur siç është kinemaja aq e munguar në vite.

Objektivi kryesor i këtij projekti është që të përfitojmë për 3 netë me radhë një spektakël artistik-kinematografik duke ruajtur vlerat më të mira të këngës dhe kinemasë shqiptare si dhe dhe asaj botërore.

Përfituesi kryesor do të jetë komuniteti të Bashkisë, si dhe grupmoshat e ndryshme të Maliqit ku do të zhvillohet ky aktivitet kombëtar. Është menduar që dhe fëmijët e vegjël të shijojnë ëndrrën e tyre nëpërmjet filmit të animuar shqiptar që do të ofrohet në ekranin e madh. Gjithashtu është menduar të shfaqet dhe një retrospektivë nga arkivat e kohës që kemi në Arkivin Shtetëror të filmit për Maliqin në vite.

Shpreh bindjen, se ky aktivitet, në këtë sezon turistik veror do të gjallëroj jetën kulturore të Bashkisë Maliqit.

FALEMINDERIT !

PËRGJEGJËSI

Festim Tomorri



KRYETARI

Gëzim TOPÇIU

